



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË ZYRËS SË RREGULLATORIT TË ENERGJISË PËR VITIN 2020

Prishtinë, qershor 2021

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

1	Opinioni i auditimit.....	3
2	Gjetjet dhe rekomandimet.....	6
3	Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit.....	7
4	Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	9
	Shtojca I: Letër konfirmimi.....	11
	Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesët e tjera të Raportit të Auditimit	12

Për: Z. Izet Rushiti - Kryesues i Bordit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë

Adresa: Dervish Rozhaja Nr.12, Prishtinë

1 Opinioni i auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2020, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet¹.

Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë (ZRRE) të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2020.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit *‘Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare’*. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

¹ Pajtueshmëria me autoritetet – pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik

² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar.

Konkluzioni i auditimit për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar gjithashtu pajtueshmërinë e menaxhmentit të ZRRE-së me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas konkluzionit tonë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit të ZRRE-së kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryesuesi Bordit është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryesuesi Bordit është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryesuesi i Bordit është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë në përputhje me Ligjin për

Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësini, dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, dhe të lëshojmë/hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objekivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keqpërfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mospajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keqpërfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së

³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet

një opinion mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë.

- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si sensitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet

Gjatë auditimit, në kategoritë e shpenzimeve kemi testuar 99 mostra në vlerë 188,723€, ndërsa për të hyrat kemi testuar 21 mostra në vlerë 1,266,757€, për qëllime substanciale dhe të pajtueshmërisë. Testet tona nuk kanë rezultuar me të gjetura.

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve te fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁴	2020 Shpenzimi	2019 Shpenzimi	2018 Shpenzimi
Burimet e fondeve	818,987	707,100	690,511	699,215	648,075
Grante Qeveritare – Buxheti	818,987	707,100	690,511	699,215	648,075

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 111,887€. Ky zvogëlim vjen si rezultat i rishikimit buxhetor dhe vendimeve të Qeverisë për kursime buxhetore.


Në vitin 2020, ZRRE ka shpenzuar 98% të buxhetit final ose 690,511€, me një përmirësim prej 2% krahasuar me vitin 2019. Se si ishte realizuar buxheti sipas kategorive janë dhënë më shpjegimet në tabelën në vijim.

Tabela 2 – Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike - (në €)


Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2020 Rezultati	2019 Rezultati	2018 Rezultati
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	818,987	707,100	690,511	699,215	648,075
Pagat dhe mëditjet	516,622	473,222	473,222	476,397	457,599
Mallrat dhe shërbimet	208,365	184,672	168,829	184,955	167,443
Komunalitë	22,000	14,395	13,648	15,090	14,638
Investimet kapitale	72,000	34,812	34,812	22,773	8,396

⁴ Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike



Grafiku 2. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2020



Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore, janë dhënë si në vijim:

- Buxheti final për paga dhe mëditje krahasuar me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 43,400€ me vendim të qeverisë. Shpenzimet në këtë kategori ishin 100% e buxhetit;

- Buxheti final për mallra dhe shërbime krahasuar me buxhetin fillestar ishte zvogëluar 23,693€, fillimisht me rishikim të buxhetit 20,000€ pastaj me vendim të qeverisë 3,693€. Në këtë kategori shpenzimet ishin 91% e buxhetit;
- Buxheti final për shërbimet komunale krahasuar me atë fillestar ishte zvogëluar për 7,605€. Fillimisht ishte zvogëluar me rishikim të buxhetit për vlerën 6,624€ dhe në fund me vendim të qeverisë për vlerën 981€.Te kjo kategori, shpenzimi i buxhetit ishte 95%; dhe
- Buxheti final investime kapitale krahasuar me buxhetin fillestar ishte zvogëluar 37,188€. Në fillim ishte zvogëluar me rishikim të buxhetit 36,000€ pastaj me vendim të qeverisë 1,188€. Në këtë kategori shpenzimet ishin 100% e buxhetit final.

Gjatë vitit 2020, për COVID – 19 janë shpenzuar 2,929€, për qëllime të dezinfektimit të objektit si dhe për furnizime me mjete dezinfektuese dhe maska mbrojtëse.

Të hyrat e realizuara nga ZRRE në 2020 ishin në vlerë 1,369,259€. Ato kanë të bëjnë me taksat vjetore të licencimit për gjenerim të ngrohjes, taksa vjetore e licencimit për gjenerim të energjisë elektrike, taksë për energjinë e importuar dhe taksë për shqyrtim të aplikacionit për autorizim për ndërtimin e kapaciteteve gjeneruese.

Tabela 3. Të hyrat(në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2019 Pranimet	2019 Pranimet	2018 Pranimet
Të hyrat	-	-	1,369,259	1,329,192	1,217,436
Totali	-	-	1,369,259	1,329,192	1,217,436

Këto të hyra transferohen në Buxhetin e Kosovës.

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të e vitit 2019 ka rezultuar me një rekomandim. ZRRE kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do të zbatohet ky rekomandim.

Nga rekomandimi i dhënë vitin e kaluar, ne kemi vërejtur që ZRRE kishte zbatuar atë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimit dhe mënyrën se si është trajtuar ai, shihni në Tabelën 4.

Tabela 4. Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2020

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2019	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1	Detyrimet e papaguara	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se pagesa e faturave bëhet në përputhje me afatet kohore të përcaktuara ligjore, ndërsa ato që kanë kaluar afatin e pagesës të prezantohen drejtë në raportin e obligimeve mujore në MF.	Ka ndërmarr masa duke paguar me kohe faturat dhe raportuar sipas afatit në MF.	I zbatuar.

Nënshkrimet:

Besnik Osmani, Auditor i Përgjithshëm

Astrit Bllaca, Udhëheqës i Auditimit

Etika Co shpk, (Fatmir Mehmeti person i autorizuar në emër të kompanisë)

Shtojca I: Letër konfirmimi

	<p>Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo</p> <p>ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI RREGULATORNI URED ZA ENERGIJU ENERGY REGULATORY OFFICE</p>							
		<table border="1"><tr><td></td><td>ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI ENERGY REGULATORY OFFICE RREGULATORNI URED ZA ENERGIJU</td></tr><tr><td>Nr.</td><td><u>752/21</u></td></tr><tr><td>Data.</td><td><u>08.06.21</u></td></tr></table>		ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI ENERGY REGULATORY OFFICE RREGULATORNI URED ZA ENERGIJU	Nr.	<u>752/21</u>	Data.	<u>08.06.21</u>
	ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI ENERGY REGULATORY OFFICE RREGULATORNI URED ZA ENERGIJU							
Nr.	<u>752/21</u>							
Data.	<u>08.06.21</u>							
<h3>LETËR E KONFIRMIMIT</h3> <p>Për pajtueshmërinë me draft raportin Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2020</p>								
<p>Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit</p>								
<p>Të nderuar,</p>								
<p>Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:</p>								
<ul style="list-style-type: none">• kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Zyrës së Rregullatorit për Energji, për vitin 2020 (në tekstin e mëtejme "Raporti"); dhe• pajtohem me përmbajtjen e Raportit.								
<p>Z. Izet Rushiti</p>								
<p>UD. Kryesues i Bordit të ZRRE-së</p>								
<p>Data: 07 qershor 2021, Prishtinë</p>								

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesët e tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁵ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁶. Ky opinion duhet të veçohet nga opinionin nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërteta, d.m.th. opinionin mund të modifikohet në lidhje me çështje (-t) e pajtueshmërisë, por mund të mos modifikohet - në lidhje me besueshmërinë e pasqyrave financiare (ose anasjelltas).

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose jo i modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim(e) material(e) ose të përhapur(a), apo te tillë(a) te mundshëm(me) të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Një keq-deklarim është një ndryshim midis shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një artikulli të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që artikulli të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinionin i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, ose janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, një e vetme ose e agreguar, që nuk është e barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare në tërësi ose keq-deklarimi (-et) dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar të transaksioneve nuk është e barabartë ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të çojë në shmangie të keq-deklarimit (-eve) material (-e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(-ve).

⁵ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë poashtu edhe deklaratat e ekzekutimit të buxhetit

⁶ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë prova të mjaftueshme të auditimit për të konkluduar se pasqyrat financiare në tërësi janë të lira nga keq-deklarimi material.

Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Ndryshimet e opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në provat e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk janë të lira nga keq-deklarimi material dhe/ose mos-pajtueshmëria ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit të mjaftueshëm për të konkluduar se pasqyrat financiare në tërësi janë të lira nga keq-deklarimi material dhe/ose mos-pajtueshmëria, auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit.

Opinionet e modifikuara mund të jenë:

- Të modifikuara (kualifikuara)
- Të kundërta, ose
- Të mohuara

Opinion i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos pajtueshmëri, një e vetme ose një agregat, që është e barabartë ose e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si një e tërë ose kur keq-deklarimi (-et) dhe / ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klasë të caktuar të transaksioneve është i barabartë ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit që nuk mund të çojë në shmangie të keq-deklarimit(-eve) material (-e).

Opinion i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, një e vetme ose një agregat, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si një e tërë ose kur keq-deklarimi (-et) dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klasë të caktuar të transaksioneve e tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret në kontekstin e gabimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive për të përshkruar efektet e gabimeve dhe/ose mos-pajtueshmërinë në pasqyrat financiare ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të gabimeve dhe/ose mos-pajtueshmërinë,

nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë prova të mjaftueshme adekuate të auditimit. Efektet të përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit:

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare
- b) Nëse kufizohen kështu, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Në lidhje me shpalosjet, janë thelbësore për kuptimin e pasqyrave financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe e përhapur.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.